

20131884650

LIGJ PËR GARANCI TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË TË OBLIGIMEVE TË MARRËVESHJES FINANCIARE PËR SIGURIM TË HUAS, TË DEDIKUAR PËR FINANCIMIN E NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME DHE PROJEKTEVE TJERA PRIORITARE FAZA IV, QË DO TË LIDHET NDËRMJET BANKËS EVROPIANE INVESTUESE DHE BANKËS MAQEDONASE PËR MBËSHTETJE TË ZHVILLIMIT

Neni 1

Republika e Maqedonisë e garanton përmbushjen e obligimeve të Marrëveshjes financiare për sigurim të huas të dedikuar për financim të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe projekteve tjera prioritare faza IV në shumë prej 100 000 000 euro, që do të lidhet ndërmjet Bankës Evropiane Investuese dhe Bankës Maqedonase për Mbështetje të Zhvillimit, nëse Banka Maqedonase për Mbështetje të Zhvillimit nuk i plotëson dhe servison obligimet në afate dhe kushte të parapara me Marrëveshje financiare.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji përcaktohen në Marrëveshjen financiare që do të lidhet ndërmjet Bankës Evropiane Investuese dhe Bankës Maqedonase për Mbështetje të Zhvillimit për Projektin për financimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe projekteve tjera prioritare faza IV.

Neni 3

Tërë obligimet financiare që dalin nga Marrëveshja financiare nga neni 1 i këtij ligji, si dhe servisimin e huas do t'i përmbushë Banka Maqedonase për Mbështetje të Zhvillimit nga të hyrat që i realizon, në afate dhe kushte të parapara me Marrëveshje financiare.

Neni 4

Huaja nga neni 1 i këtij ligji do të tërhiqet në 15 transhe. Shuma minimale e transhes është 5 000 000 euro.

Afati i pagesës së secilës transhe të huas mund të jetë nga së paku katër vite deri më së shumti tetë vite nga data e tërheqjes së transhes, me grejs periudhë të përfshirë që mund të jetë ndërmjet 60 ditësh dhe dy vitesh nga data e tërheqjes së transhes.

Afati i pagesës së huas do të caktohet për secilën transhe veç e veç në ditën e dorëzimit të kërkesës për tërheqje të mjeteve të huas nga Banka Maqedonase për Mbështetje të Zhvillimit.

Transheja mund të paguhet edhe në mënyrë të njëhershme në ditën që është ndërmjet tre dhe pesë vitesh nga dita e tërheqjes së transhes.

Neni 5

Shkalla e kamatës do të caktohet për secilën transhe të huas veç e veç në ditën e dorëzimit të kërkesës për tërheqje të mjeteve të huas nga Banka Maqedonase për Mbështetje të Zhvillimit, varësisht nga ajo se cila shkallë e kamatës është më e volitshme për Republikën e Maqedonisë (fikse apo variable).

Neni 6

Për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella që dalin nga Marrëveshja financiare dhe Marrëveshja për garanci, Ministria e Financave dhe Banka Maqedonase për Mbështetje të Zhvillimit do të lidhin marrëveshje të veçantë.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.